



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Pozicioni: Lektor/Asistent-Lektor në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit/Fakulteti I Inxhinierisë dhe Arkitekturës.

Tipologjia: Me kohë të plotë

Afati i aplikimit: 23.10.2025

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është një universitet i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike & IT. I njohur për qasjen inovative në arsim dhe kërkimin shkencor, UMT është institucioni i parë në Shqipëri që ka integruar Inteligjencën Artificiale në të gjitha ciklet e studimit, Bachelor, Master dhe Doktoraturë, në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare, duke ofruar një formim të orientuar drejt profesioneve të së ardhmes.

UMT është i angazhuar fuqimisht në ndërkombëtarizim, duke ndërtuar partneritete me universitete dhe institucione kërkimore në Europë dhe SHBA, si dhe në krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm inovacioni dhe sipërmarrjeje, që mbështet zhvillimin e ideve dhe projekteve nga studentët dhe stafi akademik.

Në kuadër të zgjerimit të ekipit të tij, UMT fton të aplikojnë kandidatë të kualifikuar, me eksperiencë dhe bashkëpunues për **pozicionin Lektor/Asistent-Lektor në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit.**

Detyrat dhe Përgjësitë

1. Të njohë mirë shkencat e strukturave, dinamikën dhe sizmikën, softueret e llogaritjes së konstruksione, llogaritjen e strukturave prej çeliku.
2. Të njohë projektimin e rrugëve dhe në përgjithësi infrastrukturën rrugore.
1. Të njohë mirë shkencat e strukturave, dinamikën dhe sizmikën, softueret e llogaritjes së konstruksioneve, llogaritjen e strukturave prej çeliku si dhe të ketë përvojë projektuese.
2. Të njohë projektimin e rrugëve dhe në përgjithësi infrastrukturën rrugore.



Kriteret kryesore për të aplikuar për pozicionin janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë bachelor dhe master shkencor në Inxhinieri Ndërtimi.
- Të ketë përfunduar të jetë në proces doktore, ose të ketë fituar Gradë shkencore, në këtë fushë.
- Të ketë interes në kërkim shkencor dhe zhvillim profesional në fushën akademike.
- Të ketë aftësi të forta organizative dhe bashkëpunuese.
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ekipit.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikuese.
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- Letër motivimi.
- CV (Curriculum Vitae) përfshirë listën e botimeve shkencore dhe referimeve në konferenca shkencore brenda ose jashtë vendit.
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit Bachelor dhe “Master i Shkencave”.
- Dëshmi e titullit “Doktor i Shkencave” apo tituj të tjerë akademikë, ose vërtetim të ndjekjes së ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”.
- Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent (MAS), ose vërtetim që janë në proces njohje.
- Portofol të punimeve të kryera.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al

***Universiteti Metropolitan Tirana rezervon të drejtën të mbyllë pozicionin sapo ai të jetë plotësuar, për shkak të rëndësisë që mbart.